

**STATUT DHE AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

“DPO Albania” SHPK

Ky statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu:

Sot më datë 15/07/2022, në Tiranë, ortaku themelues:

Z. Gent Prizreni, i biri i z.Namik, shtetas i Republikës së Shqipërisë, me numër personal identifikimi H60117098V lindur më 17.01.1976 në Tiranë dhe banues në Tiranë në adresën Rr. Ibrahim Rugova, Nd.42, H.7, Ap. 42, Njesia Administrative nr.5, 1019, Tirane , me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë, bazuar në legjislacionin shqiptar, Ligji Nr. 9901, Dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, hartoi dhe miratoi këtë statut të shoqërisë tregtare “DPO ALBANIA” shpk, e cila ka formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar. Kjo shoqëri do të ketë vulën dhe logon e saj.

KREU I

Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Emërtimi i shoqërisë

Shoqëria do të mbajë emërin “DPO ALBANIA” sh.p.k., më poshtë e quajtur edhe “Shoqëria”.

Neni 2

Selia e shoqërisë

Selia e shoqërisë “DPO ALBANIA” sh.p.k. është në adresën:Rr. Sheh Ahmet Pazari, Pll. Ambasador 3, Kati2, Ap.12, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj. Shoqëria mund të hapë filiale të tjera brenda dhe/ose jashtë vendit.

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar, duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në QKB, Tiranë.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë të shoqërisë tregtare “DPO ALBANIA” sh.p.k. është:



- 1) Konsulenca juridike dhe teknike (IT) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatesise (në zbatim të legjislacionit kombëtar dhe atij europian në këtë fushë – General Data Protection Regulation ose GDPR), te drejten e informimit dhe fusha te tjera te se drejtes.
- 2) Ofrimi i sherbimit “outsourcing” të “Nëpunësit/Zyrtarit të mbrojtjes së të dhënave personale” (njohur nderkombetarisht si Data Protection Officer – DPO) per institucione publike, shoqëri tregtare, organizata jofitimprurese, organizata ndërkombëtare dhe cdo entitet tjetër, vendas ose te huaj, etj, që sipas legjislacionit kombetar, europian etj, në këtë fushë kanë detyrimin për të caktuar një Nëpunës të mbrojtjes së të dhënave personale /DPO. Kontraktim i shrbimit tw DPO.
- 3) Trajnime në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë (per legjislacionin vendas dhe ate European GDPR), për individë, për DPO, për punonjës të shoqërive, institucioneve publike, organizatave etj.
- 4) Certifikime profesionale per individe, DPO, etj, ne fushen e mbrojtjes se te dhenave personale dhe privatesise dhe fusha të tjera.
- 5) Certifikime për institucione dhe shoqëri të ndryshme tregtare, organizata, etj, për nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale, referuar legjislacionit kombëtar, europian dhe më gjerë.
- 6) Certifikime ISO të ndryshme.
- 7) Auditime ne sektore te ndryshem, publike dhe private (kontrollues dhe përpunues), lidhur me nivelin dhe sigurinë e mbrojtjes së te dhenave personale, sigurinë kibernetike sigurinë e sistemeve dhe fusha të tjera.
- 8) Pergatitje aktesh ligjore, rregullatore, organizative ne fushen e mbrojtjes se te dhenave personale dhe privatesise, te drejtes se informimit, dhe fusha te tjera te se drejtes.
- 9) Asistencë ndaj kontrolluesve dhe përpunuesve publikë ose privatë, shqiptarë ose të huaj, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të legjislacionit vendas, atij europian dhe më gjerë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale (duke përfshirë dhe mos u kufizuar, në ndërmarrjen e të gjitha masave teknike dhe organizative të nevojshme lidhur me përpunimin e të dhënave personale, etj).
- 10) Përfaqësim të klientëve (individë, institucione publike, shoqëri tregtare, organizata jofitimprurese, organizata ndërkombëtare dhe cdo entiteti tjetër, vendas ose te huaj, etj) në konfliktet dhe procedurat administrative në mardhëniet me institucionet publike dhe proceset gjyqësore, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe fusha të tjera.
- 11) Konsulenca juridike dhe përgatitje aktesh të ndryshme ligjore, në fusha te ndryshme te se drejtes.
- 12) Bashkepunime me institucione publike, shoqëri private, organizata kombëtare ose ndërkombëtare, përfaqësi kompanish, përfaqësi diplomatike, etj, për hartimin, implementimin, dhe zbatimin e projekteve të ndryshme në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë, bashkepunime të tjera me to në këtë fushë dhe fusha të tjera.
- 13) Perfitimi i granteve, fondeve, projekteve dhe koncensioneve nga institucione publike ose private, vendase dhe të huaja në fushën e mbrojtjes së të dhënave, sigurisë kibernetike, sigurisë së sistemeve, dhe fusha të tjera të ndryshme.
- 14) Ofrimi në tregun shqiptar dhe më gjerë, i produkteve të shoqërive të njohura ndërkombëtarisht dhe me eksperiencë në fushën e mbrojtjes së të dhënave, sigurisë së sistemeve kompjuterike dhe databazave dhe fusha të tjera.
- 15) Implementimi i Rregullores Europiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR) në Shqipëri për llogari të klientëve të ndryshëm (në sektorin publik ose privat).
- 16) Trajtim kërkesash dhe ankesash të klientëve lidhur me të dhënat personale.

- 17) Përfaqësim i klientëve në raport me Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale (në rast gjobash nga kjo e fundit, ankesa, etj). Asistencë mbi detyrimet dhe zbatimin e akteve nënligjore (Udhëzime, Vendime) të Zyrës së Komisionerit, mbi përpunimin e të dhënave në sektorë të ndryshëm dhe legjislacionin në këtë fushë.
- 18) Konsulencë dhe përgatitje aktesh rregullatore për përpunimin e të dhënave për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, transferimin ndërkombëtar të dhënave personale etj.
- 19) Monitorim i proceseve përpunuese në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në çdo sektor.
- 20) Përgatitje DPIA (Data Protection Impact Assessment- Vlerësimi i Impaktit në të Dhenat Personale dhe Privatesi), SMSI (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale), praktika të ndryshme në fushën e të dhënave personale, etj.
- 21) Vlerësim dhe auditim të sigurisë kibernetike, dhe eliminimin e risqeve.
- 22) Përfaqësim GDPR në vendet e BE.
- 23) Ofrimi i shërbimit të konsulencës ligjore, teknologjisë së informacionit, konsulencë biznesi për persona fizikë, juridikë, institucione shtetërore, private etj.
- 24) Shoqëria mund të kryejë veprimtari të tjera të lidhura apo në funksion të objektit të mësipërm.

Neni 5

Ndryshimet në emërtimin, selinë, kohëzgjatjen dhe objektin e veprimtarisë

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, selinë, kohëzgjatjen dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrë Asambleja e Ortakëve.

KREU II

Kapitali

Neni 6

Kapitali themeltar

Vlera e Kapitalit fillestar të shoqërisë është 100,000 leke dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë, zotëruar në masën 100% nga Ortaku i vetëm Gent Prizreni.

Kontributi është në para dhe do të shlyhet menjëherë me themelimin e shoqërisë.

Neni 7

Zmadhimi / zvogëlimi i kapitalit dhe transferimi i kuotave

Zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit themeltar do të kryhet më vendim të asamblesë së ortakëve. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet mënyrave që parashikohen me ligj.



KREU III

ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

1. Organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve të shoqërisë.
2. Asambleja e Ortakëve është organi që miraton cdo ndryshim të statutit sipas përcaktimeve ligjore.
3. Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të mëposhtme:
 - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) Ndryshimet e statutit;
 - c) Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) Punësimin e personelit të shoqërisë në përputhje me Kodin e Punës;
 - e) Emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - f) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në gërmat (c) dhe (d) të pikës 3 të këtij neni;
 - g) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - i) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - j) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - k) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në raste të tjera ndaj administratorëve;
 - l) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - m) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë së ortakëve;
 - n) Shpërndarjen e fitimeve vjetore;
 - o) Cështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
4. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një person i tretë.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Ortakeve

1. Asambleja e ortakëve thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë apo në mënyrë elektronike: e-mail, mesazh etj.
2. Njoftimi për mbledhjen duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe t'u dërgohet ortakëve jo më pak se 7 ditë para datës së parashikuar për mbledhjen.
3. Në rastet kur asambleja është mbledhur jashtë parashikimeve të mësipërme të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme nëse të gjithë ortakët janë dakord, pavarësisht parregullsisë

Neni 10

Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë shumicë të zakonshme, asambleja mund të marrë vendime të vlefshme nëse marrin pjesë ortakët që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkin shumicë të kulaifikuar sipas nenit 87 të Ligjit “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmen e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo elektronikisht sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij Ligji.
3. Nëse asambleja e ortakëve nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë.

Neni 11 **Marrja e vendimeve**

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesmarrës, për ndryshim statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarje të fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicë të votave të ortakëve pjesmarrës për çështje si: përcaktim të politikave tregtare të shoqërisë; emerimin e administratorëve; emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar, përcaktimin e shpërblimeve; mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në rastete tjera ndaj administratorëve; Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Neni 12 **Përfshirja nga e drejta e votës**

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtë vote nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënie ose jo të përfitimeve të tjera. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi ashtu si dhe ortaku të cilin përfaqëson.

Neni 13 **Administrimi**

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit maksimal i administratorit është deri në 5 vjet me të drejte rizgjedhje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Administratori i shoqërisë për një periudhë 5 vjecare do të jetë : Gent Prizreni

Neni 14 **Kompetencat e administratorëve të shoqërisë**



1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare në marrëdhënie me persona/subjekte të tretë;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- f) të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

2. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të këtij ligji, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.

3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë shoqërinë bashkërisht apo sipas parashikimeve të Statutit.

4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Neni 15

Përgjegjësitë e administratorit

- 1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar pasojat përkatëse.
- 3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqë rite Tregtare", administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin me të mirë të shoqërisë në tërësi;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim dhe të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim a mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në baze të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

5. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

6. Në mënyrë të vecante, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara,

7. Ortaku, ka të drejtë të ngrejë padi kundër administratorit. Paditesi ka të drejtë të ndjeke në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

8. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV **Viti financiar-ekspertet**

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

1. Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gje të tillë të ngarkuar nga ana e ortakut.
2. Në përfundim të kontrollit ekspertit kontabel i autorizuar për gatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V **Prishja — Riorganizimi i shoqërisë**

Neni 18 **Prishja dhe likuidimi**

1. Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:



- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
 - b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
 - d) ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit 9723/2007;
 - e) me Vendim te gjykates.
2. Ne kete rast Ortaku merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon: menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".
 3. Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.
 4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit qe jane emeruar nga Ortaku.
 5. Nese Ortaku nuk merr nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Ligjin "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqeria do të zhvillojë aktivitetin e saj në perputhje të ploteë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqeritë tregtare", Kodit Civil dhe cfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për cdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqwsor Tiranë.

Ky akt, u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua, nga ortaku themelues si vijon:

ORTAKU THEMELUES

Z. Gent Prizreni

